

VENDIM
Nr. 878, datë 30.9.2013

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 641, DATË 31.7.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, TË
OBJEKTIT “TUNELI I NËNDETËSEVE” DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TIJ, PJESË
E PRONËS NR. 959, ME EMËRTIM “ISH-BRIGADA E NËNDETËSEVE”, PALERMO,
HIMARË, PËR TA PËRDORUR PËR NGRITJEN E MUZEUT “PANORAMA E LUFTËS SË
FTOHTË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 641, datë 31.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të objektit “Tuneli i nëndetëseve” dhe të truallit funksional të tij, pjesë e pronës nr. 959, me emërtim “Ish-Brigada e Nëndetëseve”, Palermo, Himarë, për ta përdorur për ngritjen e muzeut “Panorama e Luftës së Ftohtë””.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama